

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE – KOSOVË*

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurisë së OKB-së dhe Mendimin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Ky studim rasti është shkruar nga Fondacioni Evropian i Trajnimit (FET) si një kontribut në Inventarin e përbashkët Global të Kornizave Kombëtare dhe Rajonale të Kualifikimeve nga Qendra Evropiane për Zhvillimin e Trajnimit Profesional (Cedefop), FET, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) dhe Instituti i UNESCO-s për Mësimnxënie Gjatë Gjithë Jetës (MGJGJJ).

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi e vetme e FET-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të BE-së.

© Fondacioni Evropian i Trajnimeve, 2025



Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është i autorizuar sipas licencës ndërkombëtare Creative Commons Attribution 4.0 (CC BY 4.0). (<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>). Kjo do të thotë që ripërdorimi lejohet me kusht që të jepet merita e duhur dhe të paraqitet çdo ndryshim. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotove ose materialeve të tjera që nuk janë në pronësi të Fondacionit Evropian të Trajnimit, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejtë nga mbajtësit e të drejtave të autorit.

1. HYRJE

Kosova miratoi me ligj Kornizën e saj Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) në vitin 2008. Ajo përbëhet nga 8 nivele, të përcaktuara nga tre grupe përshtuesish; dhe është një kornizë gjithëpërfshirëse e mësimnxënies gjatë gjithë jetës, që përfshin kualifikimet nga të gjithë sektorët e arsimit, plus kualifikimet joformale.

Menaxhohet nga një agjenci autonome, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Kosova është një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), anëtar i Grupit Këshillues të KEK-ut dhe e referoi KKK-në e saj tek KEK-un në vitin 2016. KKK-ja e saj është në fazën e aktivizimit.

2. KONTEKSTI KOMBËTAR

2.1 Konteksti i politikave

Kosova u bë candidate për anëtarësim në BE në vitin 2023. Marrëdhëniet me Serbinë mbeten të tensionuara, gjë që ndikon në marrëdhëniet me BE-në.

Masat e vendosura nga BE-ja ndaj Kosovës pas përshkallëzimeve të dhunshme në veri të vendit në maj të vitit 2023 mbeten në fuqi dhe përfshijnë ngrirjen e mbështetjes financiare. Si pasojë, projektet e planifikuara të financuara nga BE-ja, përfshirë ato në arsim dhe trajnim, nuk mund të vazhdojnë tutje¹.

BPV-ja në tremujorin e parë të vitit 2024 u rrit me 5.6%, kryesisht e nxitur nga të ardhurat më të larta reale të disponueshme². Programi i Reformës Ekonomike parashikon norma vjetore të rritjes së BPV-së prej 4.8% për vitin 2025 dhe 4.4% për vitin 2026, bazuar pjesërisht në rritjen e investimeve publike.

Shifrat e FMN-së dokumentojnë rritjen vjetore të BPV-së në 4.3% për vitin 2022, 3.3% për vitin 2023 dhe parashikojnë 3.8% për vitin 2024³.

Popullsia rezidente e Kosovës po zvogëlohet. Regjistrimi i popullsisë i vitit 2024 regjistroi rreth 1.6 milion njerëz që jetojnë në vend, një rënie prej rreth 155,000 që nga viti 2011, ose një tkurrje prej rreth 9%. Migrimi jashtë vendit mbetet i lartë - diaspora e regjistruar e vendit është rreth 600,000, megjithëse shifra aktuale, meqenëse disa nuk regjistrohen për regjistrimin e popullsisë, do të jetë më e lartë.

Rënia e popullsisë ishte më parë e dukshme nga shifrat e regjistrimit në shkolla, të cilat ranë për 23.3% nga viti shkollor 2013-14 në vitin shkollor 2023-24. Për vitin e fundit shkollor, 215,431 nxënës u regjistruan në arsimin fillor dhe të mesëm⁴.

Në nivelin e mesëm të lartë, ATP-ja mbetet zgjedhja e dytë. Shkalla e regjistrimit të nxënësve të shkollave të mesme të larta në programet e ATP-së ka mbetur në rreth 50% që nga viti 2015. Të gjithë nxënësit kanë mundësinë të japin provimet e Maturës Shtetërore, pavarësisht se në cilin program regjistrohen. Përderisa kjo rregullore krijon përshkueshmëri të lartë, ajo gjithashtu kritikohet për mundësinë që u mundëson nxënësve më të dobët të anashkalojnë standardet më të larta akademike në arsimin e përgjithshëm.

Reforma në arsim dhe trajnim

Menaxhimi i arsimit parauniversitar ndahet midis Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe drejtorive komunale të arsimit (DKA) dhe shkollave.

¹ Zhvillimet kryesore të politikave në arsim, trajnim dhe punësim - Kosova 2024 | FET

² Cituar në Zhvillimet kryesore të politikave në arsim, trajnim dhe punësim - Kosova 2024 | FET

³ i njëjti

⁴ i njëjti

MASHT-I, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, hartoi Strategjinë e Arsimit 2022-2026, të cilën Qeveria e miratoi më 30 Shtator 2022. Objektivat e saj adresojnë nivelet e arsimit të hershëm të fëmijërisë, arsimit parauniversitar, ATP-së, arsimit të lartë dhe, si një politikë ndërsektoriale, dixhitalizimin e arsimit.

Në vitin 2024, u krijua një Grup Punues për të hartuar shënim konceptual të një ligji të ri për ATP-në. Pas konsultimeve publike mbi shënimin konceptual, ai u miratua në Shtator të të njëjtit vit. Shënimi konceptual tregon qëllimin e qeverisë për të bashkuar Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) me Agjencinë për ATP dhe Arsimin për të Rriturit (AATPARr). Në kohën e hartimit të këtij dokumenti (Qershor 2025), Grupi Punues i ngarkuar me hartimin e tekstit të ligjit të ri për ATP-në po finalizon një draft të parë.

2.2 Baza ligjore e KKK-së

Ligji nr. 03/L-060 për kualifikimet kombëtare, i miratuar më 7 Nëntor 2008, krijoi Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës, e cila ndonjëherë quhet KKK (Korniza e Kualifikimeve të Kosovës). Ky ligj themelor krijon Sistemin Kombëtar të Kualifikimeve, bazuar në KKK-në dhe rregullon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e KKK, si dhe dhënien e kualifikimeve.

Sipas dispozitave të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve rregullon dhënien e kualifikimeve në kornizë me përjashtim të kualifikimeve të cilat rregullohen sipas dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe kualifikimeve të rregulluara në mënyrë të qartë nga legjislacioni tjetër. Legjislacioni dytësor përkatës përfshin:

- Udhëzimin Administrativ Nr. 28/2014 mbi kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardeve të profesionit.
- Udhëzimin Administrativ Nr. 31/2014 për njohjen e mësimnxënies paraprake.
- Udhëzimin Administrativ Nr. 32/2014 mbi kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në proceset e brendshme të institucioneve të ATP-së.
- Udhëzimin Administrativ Nr. 35/2014 mbi kriteret dhe procedurat për validimin dhe miratimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Udhëzimi administrativ Nr. 09/2019 mbi kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimnxënies paraprake në Kosovë.

Legjislacioni që lidhet me KKK-në përfshin:

- Ligjin për Arsimin dhe Trajnimin Profesional (Nr. 02/L-42, 23 Shkurt 2006), i cili përcakton standardet e profesionit, ndërsa Ligji për kualifikimet kombëtare (Nr. 03/L-060, 7 Nëntor 2008) ofron një përkufizim më të përgjithshëm të standardeve.
- Ligjin Nr. 04/L138, 201 për Arsimin dhe Trajnimin Profesional.
- Ligjin Nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar (20 Gusht 2011) trajton nivelet e kualifikimeve.
- Ligjin Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë (20 Gusht 2011), që trajton nivelet dhe akreditimin e programeve dhe institucioneve të arsimit të lartë, zbatuar nga AAK-ja, ndërsa njohja e kualifikimeve të fituara jashtë vendit zbatohet nga MASHT-i.
- Ligjin Nr. 02/L-24, për arsimin dhe trajnimin e të rriturve (22 Korrik 2005), i cili përcakton certifikimin, si dhe mësimnxënien joformale dhe informale.
- Ligjin për Arsimin dhe Trajnimin për të Rritur (Ligji Nr. 04-L-143, 2012). Ky ligj siguron që njohja e mësimnxënies paraprake (NMP) bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), me kriteret dhe standarde të përcaktuara nga AKK-ja. Ai u mundëson të rriturve të fitojnë kualifikime formale përmes mësimnxënies joformale dhe informale.
- Ligjin Nr. 03/L-068, për arsimin në komunat e Kosovës (2008).

- Ligjin Nr. 03/L-018, për provimin përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore (2008).
- Ligjin Nr. 02/L-52, për arsimin parashkollor (2006).
- Ligjin nr. 06/L-046 për inspektoratin e arsimit (2019).

3. OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET E KKK-së

Objektivat e KKK-së, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-060 mbi kualifikimet kombëtare, janë:

- të ofrojë një bazë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë të kualifikimeve midis KKK-së dhe KEK-ut.
- të sigurojë transparencë duke sqaruar natyrën e kualifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe të ofrojë një bazë për krahasimin e të gjitha arritjeve në nivelet e sistemit të arsimit dhe trajnimit.
- të sigurojë që kualifikimet janë të rëndësishme për punësimin, mësimnxënien dhe të plotësojnë nevojat e studentëve, ekonomisë dhe institucioneve të arsimit dhe trajnimit.
- të promovojë zhvillimin e mësimnxënies gjatë gjithë jetës, duke përfshirë zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive për të rriturit.
- të rrisë qasjen në vlerësim dhe certifikim duke inkurajuar procese fleksibile dhe të individualizuara të mësimnxënies.
- të krijojë një sistem për grumbullimin dhe transferimin e kredive.
- të rrisë cilësinë dhe rëndësinë e arsimit dhe trajnimit duke promovuar zhvillimin e kualifikimeve të bazuara në standarde të njohurive, aftësive dhe kompetencave të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare dhe të mbështetura nga sigurimi rigoro i cilësisë.
- të rrisë mundësitë e punësimit dhe të mësimnxënies për individët duke ofruar bazën për njohjen dhe certifikimin e mësimnxënies dhe arritjeve, si dhe të mbështesë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e reformave të sistemit të arsimit dhe trajnimit bazuar në kërkesë.

4. NIVELET, REZULTATET E MËSIMNXËNIES DHE KUALIFIKIMET

4.1 Struktura e KKK-së dhe përshkruesit e niveleve

KKK-ja e Kosovës përbëhet nga tetë nivele kualifikimesh, që mbulojnë sektorët e arsimit të përgjithshëm, arsimit të lartë dhe arsimit dhe trajnimit profesional. Është një kornizë e mësimnxënies gjatë gjithë jetës, në mënyrë që kualifikimet e saj të përshtaten me të gjitha llojet e konteksteve të mësimnxënies, siç janë mësimnxënia formale, joformale dhe informale. Nivelet e kualifikimeve bazohen në rezultatet e mësimnxënies, sipas përshkruesve ekzistues të niveleve, duke dalluar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat më të gjera.

Përshkruesit, si dhe korniza në përgjithësi, ndikohen fuqishëm nga KEK-u.

4.2 Fushëveprimi dhe mbulimi i KKK-së

Ekzistojnë gjashtë lloje të specifikuara të kualifikimeve të njohura në KKK:

- Kualifikimet e Arsimit të Lartë.
- Kualifikimet e Arsimit të Përgjithshëm.
- Kualifikimet e Kombinuara Kombëtare.
- Kualifikimet Profesionale Kombëtare.
- Kualifikime të Bazuara në Standardet Ndërkombëtare.
- Kualifikime të personalizuar.

Kualifikimet zhvillohen në struktura njësie ose modulare, si në ATP ashtu edhe në AL.

Korniza e Kualifikimeve e Kosovës

Niveli i KKK-së	Kualifikimet		Niveli i KEK
	Lloji i titullit të dhënë	Lloji i kualifikimit	
8	Doktoratë - Cikli i 3-të i Bolonjës	A	8
7	Master - Cikli i 2-të i Bolonjës	A	7
6	Bachelor - Cikli i 1-rë i Bolonjës	A	6
5	Diplomë e Ciklit të Shkurtër të Bolonjës, Niveli V Diplomë pasuniversitare ATP Niveli V Certifikatë pasuniversitare ATP Niveli V	A C, D, E DE	5
4	Diplomë e arsimit të mesëm të lartë të përgjithshëm Diplomë ATP të Mesëm të Lartë Certifikatë ATP	B C, D, D, E, F	4
3	Certifikatë e Arsimit të Mesëm ATP - Niveli 3 (arsim i mesëm 2-vjeçar) Certifikatë ATP Niveli 3	C, D D, E, F	3
2	Diplomë e arsimit të mesëm të ulët Certifikatë ATP Niveli 2	B D, E, F	2
1	Diplomë e arsimit fillor Certifikatë ATP Niveli 1	B D, E, F	1

Llojet e kualifikimeve të KKK-së: Kualifikime të Arsimit të Lartë (A); Kualifikime të Arsimit të Përgjithshëm (B); Kualifikime të Kombinuara Kombëtare (C); Kualifikime Profesionale Kombëtare (D); Kualifikime të Bazuara në Standardet Ndërkombëtare (E); Kualifikime të Personalizuara (F). Burimi: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

KKK-ja është e hapur dhe përfshin kualifikimet e dhëna jashtë sistemit formal të arsimit dhe trajnimit, duke përfshirë kualifikimet e pjesshme. Lloje të tilla kualifikimesh plotësojnë nevojën për të njohur aftësitë e fituara jashtë sistemit formal, siç janë trajnimi profesional, certifikimet në industri dhe programet specifike të zhvillimit të aftësive. Në të vërtetë, dy nga llojet e kualifikimeve të listuara më sipër, Kualifikimet Profesionale Kombëtare dhe Kualifikimet e Bazuara në Standardet Ndërkombëtare, konsiderohen se mbulojnë kualifikimet joformale.

KKK-ja përfshin kualifikime ndërkombëtare. Kjo përfshin ato që i përkasin njërit prej llojeve të kualifikimeve të lartpërmendura, përkatësisht Kualifikimeve të Bazuara në Standarde Ndërkombëtare. Qëllimi i tyre është të kapin njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e përgjithshme ose profesionale, në Nivelet 1 deri në 5 të KKK-së. Këto kualifikime bazohen në standardet e vendeve të tjera ose standardet ndërkombëtare të cilat pranohen dhe përdoren brenda një profesioni ose fushe të njohur kompetencash.

Duke pasur parasysh rëndësinë në rritje të shtegjeve fleksibile të mësimnxënies dhe njohjen e aftësive të fituara përmes programeve afatshkurtra të mësimnxënies, po bëhen përpjekje për të integruar mikrokredencialet brenda kornizës. Kjo do të sigurojë përafrimin e tyre me standardet e sigurimit të cilësisë dhe njohjen e tyre brenda sistemit më të gjerë të kualifikimeve.

4.3 Përdorimi dhe ripërtëritja e rezultateve dhe standardeve të mësimnxënies

KKK-ja është ndërtuar mbi parimet e rezultateve të mësimnxënies. Kualifikimet përcaktohen përmes rezultateve të mësimnxënies të cilat përcaktojnë se çfarë pritet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë nxënësi pas përfundimit me sukses të modulit ose të programit të plotë. Për kualifikimet profesionale, rezultatet e mësimnxënies rrjedhin drejtpërdrejtë nga kompetencat e identifikuar në standardet profesionale.

Ligji Nr. 03/L-060 (Neni 2) i përkufizon standardet si tregues të matshëm të arritjeve, të përkufizuara ose në terma të kriterëve cilësorë apo sasiorë që kërkojnë të arrihen nga kandidatët për dhënien e kualifikimeve.

Në kontekstin e zhvillimit të një sistemi të kualifikimeve profesionale për Kosovën, ekzistojnë dy zbatime kryesore të shprehjes "standarde". Standardet e profesionit janë përshkrime të detyrave dhe përgjegjësisë të pritura të punës në një profesion. Rezultatet e mësimnxënies brenda standardeve të kualifikimit të miratuara janë masa të arritjeve të vlerësuara të mësimnxënies.

Siç u tregua më sipër, përcaktimi i standardeve profesionale duhet të jetë pika fillestare për zhvillimin e kurrikulave dhe vlerësimit për kualifikimet e ATP-së të bazuara në rezultate dhe programet e ATP-së të bazuara në kompetenca.

Specifikimet për një kualifikim për arsim dhe trajnim profesional gjithashtu përfshijnë një kërkesë për dëshmi të konsultimit me palët e interesuara të tregut të punës.

4.4 Marrëveshjet e sigurimit të cilësisë

Baza ligjore për sigurimin e cilësisë ofrohet nga Ligji Nr. 03/L-060 mbi kualifikimet: Neni 5 (KKK) dhe Neni 15 (Rregullorja e dhënies së kualifikimeve).

AKK-ja është përgjegjëse për përcaktimin e standardeve për validimin ose miratimin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve, dmth., autorizimin për të zhvilluar, ofruar dhe vlerësuar kualifikimet. Kualifikimet ose modulet zhvillohen nga MASHT, AATPARr, ministritë përkatëse dhe ofrues të tjerë, publik, privat dhe sektori i tretë. AKK-ja vetë nuk zhvillon kualifikime.

Kualifikimet e ATP-së duhet të bazohen në standardet profesionale nëse do të vendosen në KKK. Standardet profesionale duhet të përdoren për të ofruar një pikë referimi për identifikimin e rezultateve të mësimnxënies që duhet të mbulohen në module të ndryshme të kualifikimeve. Detyrat kryesore të identifikuar përgjithësisht në standardet profesionale do të çojnë në përcaktimin e moduleve për mësimnxënien dhe vlerësimin.

Për të arritur regjistrimin në KKK, zbatohen procedurat e mëposhtme.

Propozim i Kualifikimit për Regjistrim

- Kualifikimet që do të regjistrohen në KKK duhet të jenë në përputhje me standardet e KKK-së dhe të përshkruhen në përputhje me kërkesat e sistemit të arsimit dhe trajnimit (ATP) ose arsimit të lartë.
- Institucionet arsimore dhe të trajnimit profesional, si dhe ofruesit e tjerë të kualifikimeve, duhet të paraqesin një propozim regjistrimi që përfshin detaje rreth kualifikimit, duke përfshirë qëllimin, përmbajtjen dhe kriteret e tij për njohjen e aftësive individuale.

Vlerësimi i Kualifikimit nga AKK-ja

- AKK-ja vlerëson dhe verifikon kualifikimet e propozuara për regjistrim. AKK-ja vlerëson përafrimin e kualifikimit me standardet e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve për të siguruar që kualifikimi përmbush kërkesat përkatëse.

- AKK-ja mund të kërkojë ndryshime në përmbajtjen e kualifikimit ose mund të kërkojë informata shitesë për të verifikuar nëse kualifikimi përputhet me kërkesat e përcaktuara nga KKK-ja.

Regjistrimi në KKK dhe publikimi

- Pas miratimit dhe përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm, kualifikimi regjistrohet në KKK. Ky proces menaxhohet nga AKK, i cili siguron që të gjitha kualifikimet e regjistruara të jenë në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Pasi të regjistrohet, kualifikimi bëhet i arritshëm për të gjithë, përfshihet në listën e kualifikimeve të regjistruara në KKK dhe mund të publikohet në platforma dhe burime të disponueshme për individë dhe institucione.

Monitorimi

- Pas regjistrimit të kualifikimeve, monitorimi është një proces i rëndësishëm për të siguruar që ato të mbeten të përditësuara dhe relevante për kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e reja në sektorët përkatës.
- Nëse është e nevojshme, kualifikimi mund të rishikohet ose përmirësohet për t'u përshtatur me nevojat e reja ose për të integruar ndryshimet në standardet për kualifikimet.

Udhëzimi administrativ i AKK-së përcakton procesin e akreditimit të ofruesve. Deri më tani, AKK-ja ka akredituar pothuajse në total 100 ofrues ose institucione. Këto janë qendra private të trajnimit profesional (QAP); QAP publike, të cilat ofrojnë trajnime për të rriturit, përfshirë kërkuesit e punës; ofrues të tjerë të ATP-së; shkolla publike të ATP-së; dhe shkolla private të ATP-së.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë. Universitetet zhvillojnë kualifikimet e tyre, të cilat sigurohen nga AKA-ja.

Kriteret për vlerësimin dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë përfshijnë politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë së programeve dhe çmimeve të tyre të studimit. Në arsimin e lartë, janë të akredituara 21 institute. AKA-ja është gjithashtu përgjegjëse për akreditimin e kolegjeve të AFP-së pas-sekondare.

5. RREGULLIMET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT

5.1 Qeverisja dhe rregullimet institucionale për KKK-në

AKK-ja, e themeluar në vitin 2008, ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e KKK-së. Ajo i përgjigjet një bordi drejtues prej 13 anëtarësh që përfaqësojnë ATP-në, arsimin e përgjithshëm, arsimin e lartë, sindikatat, punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve, odat tregtare dhe organet vullnetare. Poashtu është agjencia e caktuar në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në përgjithësi ka rreth 12 të punësuar të AKK-së, përfshirë drejtorin e saj; specialistë në sigurimin e cilësisë, kualifikimet, standardet profesionale, monitorimin, njohjen e mësimnxënies paraprake, zyrtarë; plus stafin administrativ për buxhetin dhe financat, IT-në dhe dhe asistent administrativ për mbështetje të përgjithshme.

AKK-ja gjatë një viti tipik angazhon rreth 100 ekspertë të jashtëm për të kryer proceset e verifikimit, validimit dhe akreditimit.

Siç u tregua më sipër, në kohën e shkrimit të këtij dokumenti, ishin duke u zhvilluar diskutime rreth një integrimi të mundshëm të funksioneve të AKK-së në institucione të tjera, dhe rrjedhimisht shpërbërjes së agjencisë si një organ autonom.

5.2 Rolet dhe funksionet e palëve të veprimit dhe të interesit

Përderisa AKK-ja udhëheq dhe koordinon KKK-në, ajo ndan përgjegjësinë për zhvillimin dhe zbatimin e kornizës me MASH-in, në arsimin e përgjithshëm dhe AKA-në për arsimin e lartë.

AKK-ja është përgjegjëse për regjistrimin e kualifikimeve të ATP-së dhe arsimit për të rritur të zhvilluara nga ofrues të tillë si shkollat e ATP-së ose shkollat ose akademitë profesionale speciale, siç është kolegji i policisë, brenda kornizës. Siç u tregua më sipër, ajo është përgjegjëse për akreditimin e ofruesve të ATP-së dhe kryen procese të sigurimit të cilësisë që lidhen me validimin, vlerësimin dhe certifikimin e këtyre kualifikimeve për të siguruar që ato janë të cilësisë së mjaftueshme për t'u përfshirë në KKK.

MASHT-i mbikëqyr kualifikimet e arsimit të përgjithshëm dhe zhvillon kualifikime të përgjithshme në nivelin e shkollës së mesme, të tilla si diploma e shkollës së mesme të ulët dhe matura e shkollës së mesme të lartë.

Në arsimin e lartë, AKA-ja mbikëqyr ofrimin e arsimit të lartë dhe akrediton institucionet e arsimit të lartë si ofrues. Universitetet në përgjithësi zhvillojnë kualifikimet e tyre, cilësia e të cilave sigurohet nga AKA-ja. AKA-ja mbikëqyr nga bordi i saj drejtues, Këshilli Kombëtar i Cilësisë.

Këshilli për Arsimin dhe Trajnimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (KATPARr) është organi këshillimor mbi politikat e ATP-së dhe Arsimit për të Rriturit për ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë. Është një organ trepalësh, që angazhon qeverinë, punëdhënësit dhe sindikatat në AFP. KATPARr-i përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë, të cilët përfaqësojnë ministritë e arsimit dhe punës, ministritë e tjera përkatëse, AKK-në, ATPARr-në, Odën Ekonomike të Kosovës dhe partnerët socialë.

KATPARr-i ka përgjegjësinë statutores për miratimin e standardeve profesionale për sistemin e ATP-së. Është përgjegjësi e KATPARr-së të sigurojë që standardet e propozuara plotësojnë nevojat e tregut të punës në Kosovë, si dhe të sigurojë mbështetje nga të gjitha palët e interesuara. Ajo ia përcjell AKK-së standardet e miratuara profesionale për procesin e verifikimit.

AATPARr-ja ka përgjegjësi të gjera në ATP, duke përfshirë koordinimin e programeve të studimit që kanë të bëjnë me ATP-në dhe arsimin e të rriturve, angazhimin e partnerëve socialë dhe mbikëqyrjen dhe koordinimin e zhvillimit të standardeve profesionale. Edhe pse AATPARr-ja supozohet të përmbushë këtë funksion për të gjitha shkollat e ATP-së, aktualisht këtë e bën vetëm për gjashtë të ashtuquajturat Qendra të Kompetencës, të cilat janë shkolla të ATP-së të financuara nga donatorët që specializohen në një sektor, p.sh., biznes/tregti. Marrëdhënia e saj me AKK-në dhe palët tjera të veprimit dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse duhet të sqarohen gjersa agjencia zhvillohet.

Palët e interesit që janë jashtë institucioneve kryesore shtetërore janë të angazhuara nëpërmjet KATPARr-së dhe Bordit Drejtues të AKK-së. Odat Ekonomike të Kosovës, Shoqata e Biznesit të Kosovës dhe përfaqësues të tjerë sektorialë, kontribuojnë me ekspertizën e tyre në Agjenci si përfaqësues dhe në Bordin Drejtues të AKK-së si bashkë-vendimmarrës.

6. NJOHJA DHE VALIDIMI I MËSIMNXËNIES PARAPRAKE

6.1 Njohja dhe validimi i mësimnxënies joformale dhe informale dhe shtegjeve të mësimnxënies

Dizajnimi i një sistemi për Validimin e Mësimnxënies Joformale dhe Informale (VMJI) në Kosovë filloi në vitin 2011, me miratimin e KKK-së dhe zhvillimin e udhëzimeve të para mbi përfitimet dhe përdorimet e Njohjes së Mësimnxënies Paraprake (NMP).

Që atëherë, janë zhvilluar politika kombëtare, legjisllacioni dytësor dhe module trajnimit për zbatimin e NMP-së. Dy akte nënligjore janë zhvilluar dhe miratuar nga ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 31/2014 për njohjen e mësimnxënies paraprake, i miratuar në vitin 2014. Ai përshkruan fushëveprimin, dispozitat e përgjithshme, parimet, përgjegjësitë dhe procedurat për njohjen e mësimnxënies joformale dhe informale, brenda të gjitha niveleve të KKK-së.
- Udhëzimi administrativ Nr. 09/2019 mbi kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimnxënies paraprake në Kosovë, i miratuar në vitin 2019. Ai përshkruan parimet, përgjegjësitë dhe procedurat për akreditimin e ofruesve të ATP-së për të zbatuar NMP-në. Megjithatë, ai përfshin vetëm akreditimin e kualifikimeve të KATP-së dhe nuk mbulon kualifikimet e IATP-së.

Të dy udhëzimet administrative janë në përputhje me Rekomandimin e Këshillit për Validimin e Mësimnxënies Joformale dhe Informale.

Validimi mund të çojë në kualifikime të pjesshme dhe të plota të KKK-së, varësisht nga rezultatet e vlerësimit. Nëse një kandidat demonstroi kompetencë në njësi të caktuara të një kualifikimi, ai mund të marrë certifikim të pjesshëm dhe të grumbullojë kredi që më vonë mund të kontribuojnë në marrjen e një kualifikimi të plotë.

Për momentin, VMJI është i mundur vetëm për Kualifikimet Profesionale Kombëtare që kanë cilësi të garantuar me anë të validimit dhe të miratuara në KKK. Aktualisht, ekzistojnë 125 Standarde Kombëtare Profesionale të verifikuara dhe të miratuara në KKK.

Deri më tani, tetë ofrues janë akredituar për të dhënë kualifikime nëpërmjet NMP-së në fusha duke përfshirë parukeri, saldim dhe instalues elektrik.

AKK-ja ofron një platformë dixhitale në të cilën kandidatët regjistrojnë interesin e tyre për t'u vlerësuar për çmime nga institucionet e akredituara. AKK-ja ka zhvilluar gjithashtu një platformë elektronike të akreditimit për procesin e akreditimit.

Kosova ia paraqiti Grupit Këshillimor të KEK raportin e saj të vetëm mbi VMJJ në Shkurt 2020, duke përshkruar legjisllacionin e zhvilluar dhe hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë në zbatimin e NMP-së.

Tani që VMJI-ja është vendosur fuqimisht në vend, agjencia kombëtare e punësimit, APRK⁵, ka prezantuar NMP-në si një Masë shtesë Aktive të Tregut të Punës (MATP) për punëkërkesit e regjistruar për të mbështetur qasjen e tyre në tregun e punës ose për zhvillimin e karrierës së tyre.

6.2 Sistemet e kredisë

AKK-ja ka zhvilluar një sistem kredisë të ATP-së bazuar në rekomandimet e QEATP-së. Një kredi jepet për 20 orë mësimi nominal.

Sistemi i kredive i AKK-së përdor rezultatet e mësimnxënies, kategorizon kualifikimet duke matur vëllimin e mësimnxënies dhe identifikon ofruesit që kanë një rol dhe përgjegjësi në ndarjen e kredive. AKK-ja rregullon sistemin e kredive duke akredituar ofruesit dhe duke vendosur kriteret për të përcaktuar se cilët ofrues mund të paraqesin kualifikime për përfshirje në KKK. Këto kriteret përfshijnë [procedura rigoroze për ndarjen e kredive](#), të cilat sigurojnë që ofruesit të kenë kapacitetin dhe ekspertizën e nevojshme.

Është krijuar një sistem kredisë për sektorin e arsimit të lartë dhe është i përafëruar me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS).

⁵APRK – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

6.3 Promovimi i mësimnxënies gjatë gjithë jetës

Në fushëveprim, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është mësimnxënie gjatë gjithë jetës.. Një nga objektivat e saj është të lehtësojë akumulimin dhe transferimin e rezultateve të mësimnxënies ndërmjet konteksteve apo sistemeve të ndryshme të mësimnxënies. Kjo përfshin rezultatet e fituara nëpërmjet mësimnxënies formale dhe joformale. Një transferim i tillë mbështet lëvizshmërinë gjeografike dhe profesionale të nxënësve duke u mundësuar atyre të grumbullojnë dhe kombinojnë rezultatet e mësimnxënies nga mjedise të ndryshme dhe t'i përdorin ato në shtegje të ndryshme arsimore.

Korniza përfshin kualifikime të zhvilluara nga organe jashtë sistemit formal kombëtar.

7. ZBATIMI DHE NDIKIMI I KKK-së

7.1. Faza e zbatimit

Kosova ka miratuar një kornizë të gjerë ligjore, ka krijuar një agjenci të dedikuar kryesore, ka vendosur kualifikimet në KKK-në dhe certifikatat mbajnë indicie të nivelit. Megjithatë, KKK-ja ende nuk ofron vazhdimisht një platformë për palët e interesit dhe ende nuk mund të thuhet se mbështet ose ndikon plotësisht në reformat përkatëse, p.sh., në kurrikula. Prandaj, KKK-ja e saj është në fazën e aktivizimit.

Është bërë përparim i rëndësishëm në plotësimin e kornizës me kualifikime të përcaktuara nga gjashtë llojet. Përfshihen kualifikimet formale dhe joformale. Rëndësia e tyre për tregun e punës sigurohet nëpërmjet përdorimit të standardeve të profesionit, bazuar në dialogun me punëdhënësit dhe aktorët e tjerë të tregut të punës dhe kontributin e tyre.

Kualifikimet e zhvilluara nga punëdhënësi tani përfshihen edhe në KKK dhe në regjistrin e kualifikimeve. Për shembull, “Shehu” dhe “Dekoriti”, kompani private në sektorin e drurit dhe mobiljeve, kanë zhvilluar një kualifikim në zdrukhtari, i cili është përfshirë në KKK në Nivelin 4. Në mënyrë të ngjashme, Korporata Energjetike e Kosovës, një kompani publiko-private, ka zhvilluar një kualifikim të Nivelit 4.

Si shtesë e kualifikimeve në KKK (shih seksionin 7.4 më poshtë), numri i standardeve të profesionit të miratuara është rritur nga 88 në vitin 2018 në 125 tani. Aktualisht janë duke u verifikuar 30 standarde të tjera..

Ka përparim të konsiderueshëm në NMP. Ekziston legjislacioni dytësor dhe ofrohet trajnim për vlerësuesit dhe profesionistë të tjerë. Tetë institucione janë akredituar për të kryer procedurat e NMP-së. NMP-ja tani gjithashtu përdoret si një Masë Aktive e Tregut të Punës (MATP) për të rritur qasjen në punësim për punëkërkuesit.

7.2 Tregimi i niveleve të NMP-së/KKK-së

Nivelet e KKK-së dhe KEK-ut shfaqen në pothuajse të gjitha dokumentet e kualifikimeve, të tilla si certifikatat, diplomatat dhe certifikatat, si dhe në Europass dhe shtojcat e diplomave në ATP-së dhe AL-së.

7.3 Shpërndarja e KKK-së

Nuk ka një strategji të përgjithshme komunikimi, por mediat e përdorura përfshin fletëpalosje në kopje të printuar, reklama televizive dhe përmbajtje në mediat sociale.

Në një nivel më teknik, AKK-ja lëshon udhëzues specifikë për KKK-në. Ka botuar një [dorracak mbi KKK-në](#). Dorracaku mbulon rishikimet më të fundit të KKK-së. Ai përdoret nga palë të ndryshme të interesit, duke përfshirë institucionet qeveritare, odat ekonomike, shoqatat civile, shkollat dhe ofrues të tjerë. Ai mbështet palët e interesit në kuptimin e tyre të përgjithshëm të kornizës, p.sh., qëllimet e saj, strukturën e saj, etj., dhe ndihmon përdoruesit aktivë që mund ta konsultojnë dorracakun për të zbatuar udhëzimet e tij në procese të tilla siç është zhvillimi i kualifikimeve. Këto udhëzime janë shpërndarë në kopje të printuar tek palët e interesit të KKK-së.

7.4 Bazat e të dhënave dhe regjistrat e kualifikimeve

Regjistri i Kualifikimeve të Kosovës (RKK) është ende në zhvillim e sipër dhe ende nuk është funksional si një platformë e integruar. Megjithatë, KKK-ja tashmë përmban 145 kualifikime të ATP-së në nivelet 1 deri në 5 dhe 355 kualifikime të arsimit të lartë.

Kualifikimet në arsimin e përgjithshëm jepen në fund të një programi mësimor nga MASHT-i. Këto kualifikime zhvillohen dhe sigurohen për cilësi nga departamenti i arsimit parauniversitar i MASHT-it, bazuar në standardet kombëtare për kualifikimet dhe fushat e tyre kurrikulare. Ato përfshihen ose nivelohen automatikisht në KKK. Kualifikimet standarde të përgjithshme të përfundimit të shkollës janë Matura, në Nivelin 4.

Përshkrimet e rezultateve të mësimnxënies përdoren në RKK. Kosova përdor certifikatën Europass dhe shtojcat e diplomës për ATP dhe AL, ku përshkruhen rezultate të shkurtra të mësimnxënies.

Kosova gjithashtu mirëmban lista të standardeve profesionale dhe programeve të arsimit të lartë, të cilat janë të lidhura me regjistrin e kualifikimeve. Regjistri është i qashtë në Shqip, Serbisht dhe Anglisht.

Deri më tani, regjistri i kualifikimeve ka qenë i ndarë në tre kategori, ATP, AL dhe arsim i përgjithshëm, por AKK-ja është në proces të zhvillimit të një RKK-je të integruar, i cili do të ofrojë një format të vetëm për të gjitha llojet e kualifikimeve.

RKK-ja aktuale tashmë ndjek kryesisht fushat në Shtojcën VI të Rekomandimit të KEK-ut, i cili propozon fusha të të dhënave për publikimin elektronik të informacioneve për kualifikimet me një nivel të KEK-ut. Struktura e re e platformës KRQ synon t'i përmbahet edhe më ngushtë. AKK-ja planifikon ndërveprimin me sistemet dhe veglat e BE-së, duke përfshirë lidhjen e RKK-së me Platformën Europass, dhe duke siguruar që modeli i të dhënave i zhvilluar për publikimin e informatave është në pajtueshmëri me Modelin Evropian të të Mësimnxënies⁶.

7.5 Përdorimi i KKK-së në njohjen e kualifikimeve të huaja

KKK-ja e Kosovës ofron një bazë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë të kualifikimeve të larta ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera. Një hap i parë është sigurimi i përputhshmërisë me "Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë" të zhvilluara nga AEKK.

Njohja e kualifikimeve të huaja në arsimin e lartë rregullohet përmes zyrës së NARIC në Kosovë. MASHT është përgjegjëse për programet formale të ATP-së (shkollat). Në ATP-në joformale, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve shërben si një mjet njohjeje bazuar në elementë të përbashkëta.

7.6 Udhëzimi dhe këshillimi në karrierë

⁶Modeli Evropian i të Mësimnxënies, apo MEM, ofron një fjalor të vetëm për të dhënat e të mësuarit dhe punësimit në Evropë dhe përdoret për platformën Europass.

MASHT, me mbështetjen e LuxDev, ka krijuar një [platformë për orientim profesional, edukim dhe udhëzim në karrierë](#). Platforma mbështet si nxënësit ashtu edhe studentët, si dhe institutet në edukimin dhe udhëzimin në karrierë.

Platforma ofron disa mjete dhe informata në platformë në lidhje me hapat e mëposhtëm në orientimin në karrierë:

- Vetënjohja përmes testeve të karrierës.
- Validimi i aftësive të lidhura me karrierën – Testi i Vlerësimit të Potencialit për Kontrollin Bazë.
- Duke eksploruar tregun e punës.
- Duke eksploruar institucionet arsimore në Kosovë.
- Identifikimi i mundësive për punë dhe/ose praktikim.
- Këshilltar online.

Platforma u ofron instituteve, politikëbërësve dhe biznesit katër module për të lehtësuar ndërveprimin midis arsimit dhe tregut të punës:

- Ndërlidhës Industrial.
- Vlerësimi i Nevojave për Trajnim.
- Vlerësimi i Nevojave për Aftësi dhe Njohuri.
- Monitorimi dhe Vlerësimi.

7.7 Ndërgjegjësimi dhe përdorimi i KKK-së

AKK-ja ka qenë aktive gjatë viteve në angazhimin e ofruesve, punëdhënësve dhe donatorëve për të rritur ndërgjegjësimin për KKK-në, funksionet dhe vlerën e shtuar të saj. Ka përdorur reklama televizive, mediat sociale, punëtori informuese dhe ngjarje të tjera ballë për ballë.

Palët institucionale të interesit, siç janë shkollat e ATP-së, disa zhvillues të kualifikimeve, p.sh., Kolegji i Policisë, të cilët domosdoshmërisht vijnë në kontakt me AKK-në dhe KKK-në kur kërkojnë akreditim të programeve ose validim të kualifikimeve, dhe nxënësit, kanë një ndërgjegjësim mjaft të lartë për kornizën.

Praktikuesit e udhëzimit dhe këshillimit në zyrat e punësimit përdorin KKK-në në konsultime me njerëzit për të mbështetur vendimet e tyre mbi shtegjet e karrierës, kualifikimet dhe programet.

Palët e interesit në industri dhe tregti, si dhe sindikatat, janë institucionalisht të lidhura me KKK-në nëpërmjet Bordit të KKK-së dhe Këshillit për Arsimin dhe Trajnimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve. Kontaktet më të gjera me partnerë të tillë bëhen nëpërmjet takimeve me odat tregtare, sindikatat dhe zyrat e punësimit, si dhe ftesave për seminare, diskutime publike etj.

Agjencia e Punësimit e Kosovës (APRK) luan një rol vendimtar në lidhjen e punëkërkuësve me tregun e punës dhe në ofrimin e udhëzimeve mbi zhvillimin e aftësive dhe kualifikimeve. Megjithatë, niveli i ndërgjegjësimit dhe angazhimit me KKK-në dhe KEK-un midis këtyre shërbimeve është ende në zhvillim e sipër.

Dorracaku i KKK-së mbulon të gjithë informacionet dhe funksionet e zbatimit të mekanizmit të KKK-së. Drafti i rishikuar (2020) i dorracakut të KKK-së është zhvilluar nga stafi i AKK-së, i mbështetur nga ekspertë dhe konsulentë të ndryshëm.

AKK-ja po zhvillon platforma dixhitale për standardet e profesionit.

7.8 Monitorimi dhe vlerësimi i KKK-së

Ende nuk është zbatuar një vlerësim gjithëpërfshirës i ndikimit ose përdorimit të KKK-së.

7.9 Ndikimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve

Paragrafi 7.4 tregon numrin e kualifikimeve në KKK dhe në regjistër. Këto kualifikime i janë drejtpërdrejt në dispozicion publikut për shkak të KKK-së dhe kritereve të saj të sigurimit të cilësisë, siç zbatohen nga AKK-ja dhe AKA-ja.

Zbatimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë ka promovuar ndjeshëm përdorimin e rezultateve të mësimnxënies në nënsisteme të ndryshme të arsimit dhe trajnimit, në kualifikime, standarde dhe kurrikula.

Në ATP, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) ka siguruar që kualifikimet, veçanërisht nëpërmjet standardeve profesionale të prezantuara nëpërmjet proceseve të KKK-së, të jenë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Në arsimin e përgjithshëm, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) ka kontribuar në kurrikula më të strukturuar dhe të fokusuar në rezultate. Në arsimin e lartë, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) ka përafruar kualifikimet e Kosovës me standardet evropiane, duke rritur sigurimin e cilësisë dhe njohjen akademike.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) në Kosovë ka rritur ndjeshëm lëvizshmërinë ndërkombëtare të qytetarëve duke i përafruar kualifikimet e Kosovës me KEK-un, ndërsa dukshmëria është rritur nëpërmjet vulosjes së niveleve të KKK-së dhe KEK-ut në certifikata dhe shtojca të certifikatave.

8. REFERIMI NË KEK

8.1 Referimi në KEK

Kosova ka qenë anëtare e Grupit Këshillues të KEK-ut që nga viti 2015 dhe e ka referuar KKK-në e saj me KEK-un në vitin 2016. AKK-ja i ofron përditësime të rregullta Grupit Këshillues mbi progresin e KKK-së së Kosovës, duke përfshirë raportin e saj të vitit 2020 mbi VMJI.

Kosova nuk është anëtare e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL), ose e Procesit të Bolonjës, dhe për këtë arsye nuk mund t'i bashkohet KK-ZEAL, për shkak të kundërshtimit politik ose vetos nga Serbia dhe disa shtete anëtare të BE-së.

8.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Objektiv kryesor i KKK-së, i specifikuar në ligjin e KKK-së, është të ofrojë një bazë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë midis KKK-së dhe KEK-ut. AKK-ja është pika e Koordinimit Kombëtar e caktuar për pjesëmarrje në procesin e KEK-ut.

AEKK ka ndryshuar statusin e AKA-së në “nën shqyrtim”, një ulje e vlerësimit të saj të mëparshëm. AKA është anëtare e plotë e Rrjetit të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (RrASCALEQL) dhe Rrjetit Ndërkombëtar për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (RrNASCAL).

Ndihma e BE-së për Kosovën në kuadër të sektorit prioritar Arsimit, punësimi dhe politikat sociale (ndihma financiare në kuadër të IPA II përqëndrohet në: (i) përmirësimin e funksionimit të tregut të punës; (ii) rritjen e standardeve të arsimit; (iii) promovimin e zhvillimit të aftësive; dhe (iv) ristrukturimin e sistemit të mirëqenies sociale.

Masat e vendosura nga BE-ja ndaj Kosovës në Qershor 2023 janë ende në fuqi, duke kufizuar kontaktet e nivelit të lartë dhe rrjedhën e fondeve të bashkëpunimit dypalësh. Në fakt, sasi të konsiderueshme të ndihmës së BE-së janë pezulluar për shkak të këtyre masave.

Një komunitet i madh ndërkombëtar donatorësh është aktiv në vend. AKK-ja merr mbështetje nga donatorët DVV International e Gjermanisë. Mbështetje të tjera nga donatorët për sistemin e ATP-së në Kosovë vijnë nga organizatat ndërkombëtare, p.sh., OKB-ja, dhe donatorë bilateralë si Luksemburgu, Austria, Gjermania dhe Zvicra.

9. REFLEKTIME DHE PLANE

Faktorët që mundësojnë përparimin e KKK-së përfshijnë drejtimin e saj nga ekspertët në formën e AKK-së. KKK-ja përfshin një numër të konsiderueshëm kualifikimesh dhe është e hapur për të gjitha llojet, përfshirë arsimin joformal. Progresi ka qenë i fortë në zhvillimin e standardeve të reja. Një sukses tjetër ka qenë krijimi i një sistemi validimi për të njohur dhe certifikuar kompetencat e fituara jashtë arsimit formal.

Përderisa AKK-ja është një aktor kritik në reformën e ATP-së në Kosovë, struktura e përgjithshme e qeverisjes së arsimit, përcaktimi i roleve dhe ndarja e funksioneve është e ndërlikuar. Qeveria synon që, nga ana e ATP-së, projektligji, pasi të miratohet, t'i zgjidh këto probleme.

Angazhimi i plotë i palëve të ndryshme të interesit, siç janë departamentet qeveritare, partnerët socialë, agjencitë dhe institucionet, të nevojshëm për të siguruar një zbatim të qëndrueshëm të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) në planin afatgjatë, ka rezultuar i vështirë. Megjithatë, duhet thënë se mungesa e një sektori privat të madh dhe të lulëzuar, i cili do të përfshinte ndërmarrje mjaftueshëm të mëdha për t'i kushtuar vëmendje arsimit dhe trajnimit, është një arsye e kuptueshme.

Edhe pse zhvillimi i numrit të standardeve të profesioneve është rritur ndjeshëm vitet e fundit, numri i miratimeve mund të rritet duke identifikuar profesionet prioritare.

Numri i kualifikimeve të akredituara të zhvilluara nga ofruesit publikë të ATP-së është ende i kufizuar.

Prioritetet përfshijnë:

- Mbushjen e kornizës me kualifikime të reja që janë të dobishme për nevojat e njerëzve dhe në të njëjtën kohë i nënshtrohen një vlerësimi të cilësisë dhe janë të përshtatshme për tregun e punës.
- mbështetjen e qëllimeve të mësipërme, zhvillimin e standardeve të reja profesionale dhe rishikimin e atyre ekzistuese nga aktorët përfaqësues të sektorit.
- zhvillimin e programeve të reja që çojnë në kualifikime që do të mbështesin punësimin e njerëzve.
- rishikimin e përgjithshëm të regjistrit të kualifikimeve, i cili do ta afronte atë më shumë me linjat e BE-së, me të dhëna të organizuara rreth mjeteve të BE-së si MEM; duke e bërë regjistrin më miqësor ndaj përdoruesit ose publikut.

SHKURTESAT

ALMM	Masa e Tregut Aktiv të Punës
AVETAE	Agjencia për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Arsim për të Rritur
CVETAE	Këshilli për Arsimin dhe Trajnimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur
CEENQA	Rrjeti i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore
DVV Ndërkombëtare	Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Deutscher Volkshochschul Verband (shoqata e arsimit të të rriturve)
EARK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ECTS	Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive
ECVET	Sistemi evropian i kredive për arsimin dhe trajnimin profesional
BE	Bashkimi Evropian
ENQA	Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
EQAVET	Sigurimi evropian i cilësisë në arsimin dhe trajnimin profesional
KEK	Korniza evropiane e kualifikimeve
ERP	Programi i Reformës Ekonomike
GE	Arsimi i Përgjithshëm
AI	Arsimi i Lartë
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
INQAAHE	Rrjeti Ndërkombëtar për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
IT	Teknologjia Informatike
KAA	Agjencia e Akreditimit e Kosovës
KESP	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
KRQ	Regjistri i Kualifikimeve i Kosovës
LO	Rezultatet e mësimnxënies
MESTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

NDS	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
KKKP	Korniza Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
RPL	Njohja e mësimnxënies paraprake
VET	Arsimi dhe trajnimi profesional
VNFIL	Validimi i mësimnxënies joformale dhe informale
QTP	Qendrat e trajnimit profesional

REFERENCAT

Fondacioni Evropian i Trajnimit (FET), *Zhvillimet kryesore të politikave në arsim, trajnim dhe punësim – Kosova, 2024, Torino 2025*. Në dispozicion në internet në: [Zhvillimet kryesore të politikave në arsim, trajnim dhe punësim - Kosova 2024 | ETF](#)

Fondacioni Evropian i Trajnimit (FET), *Validimi i mësimnxënies joformale dhe informale – Kosova 2024, Torino 2024*. Në dispozicion online në: [Validimi i të nxënit joformal dhe informal – Kosovë | ETF](#)

Zyra e Kryeministrit, *Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2030*. Në dispozicion në internet në: <https://kryeministri.rks-gov.net/sq/strategjia-e-zhvillimit-kombetar-2030/>

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Strategjia e Arsimit e Kosovës*. Në dispozicion në internet në: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/03-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Alb-Web.pdf>